




GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet:

KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS (KGJK)

dhe

GRUPIT PËR STUDIME JURIDIKE DHE POLITIKE (GLPS)

për implementimin e projektit të titulluar:

‘Fostering Demand for Justice in Kosovo through Informed Engagement of Civil Society’ (*shqip:*
“Nxitja e Kërkesës për Drejtësi në Kosovë përmes Angazhimit të Shoqërisë Civile”)

Numri i kontratës: SINLEC19GR0031

Financuar nga: Departamenti i Shtetit Amerikan, përmes programit - Bureau of International
Narcotics and Law Enforcement Affairs (INL)

Janar 2019

Neni 1 [Fushëveprimi]

Ky Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet KGJK-së dhe GLPS-së lidhet me qëllim të mundësimit të zbatimit të projektit të titulluar: 'Fostering Demand for Justice in Kosovo through Informed Engagement of Civil Society' (*shqip*: "Nxitja e Kërkesës për Drejtësi në Kosovë përmes Angazhimit të Shoqërisë Civile"), nr. i kontratës. SINLEC19GR0031, financuar nga: Departamenti i Shtetit Amerikan, përmes programit - Bureau of International Narcotics and Law Enforcement Affairs (INL) dhe zbatuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (nr. i regjistrimit 5110959-7). Qëllimi i këtij Memorandumi është që të përcaktoj veprimet e përbashkëta ndërmjet KGJK-së dhe GLPS-së sa i përket zbatimit të Programit të Praktikës së Juristëve në Gjykatat e Kosovës, në kuadër të këtij projekti.

Neni 2 [Qëllimi i Memorandumit]

Qëllimi i Programit të Praktikës së Juristëve në Gjykatat e Kosovës është që t'u ofroj juristëve të sapo diplomuar mundësinë e marrjes së njohurive dhe shkathtësive praktike në lëminë gjyqësore, përmes vendosjes së tyre në gjykatat themelore të Kosovës, dhe ofrimin e mundësisë së njohjes së mëtejme të procedurave civile, penale dhe konfliktit administrativ. Ky Program do të zgjas 6 (gjashtë muaj) dhe do të përfshij një numër prej 40 (dyzet) praktikantëve, të cilët do të kompenzohen në mënyrë simbolike nga Projekti (përkatesisht GLPS) për pjesëmarrjen e tyre në këtë Program. Programi do t'u mundësoj të njëjtëve që, bazuar në përvojën e fituar, të njëjtën t'ju njeh si përvojë zyrtare në raport me kriteret e kërkuara për tu regjistruar në profesionet e lira ligjore (sipas ligjeve përkatëse).

Neni 3 [Përgjegjësitë e KGJK-së]

Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të marr përsipër që bazuar në mundësitë që kanë gjykatat themelore në Republikën e Kosovës, t'i vendos të 40 (dyzet) praktikantët nëpër gjykatat përkatëse, dhe t'u mundësoj atyre marrjen e përvojave nga proceset ditore të gjykimeve, për një periudhë gjashtë mujore, vetëm gjatë vitit 2019. Praktikantët do të pajisen me leje hyrje-dalje nëpër objektet e gjykatave dhe do të vendosen në zyret e gjyqtarëve apo administratës, ku edhe do të kryejnë shërbimin e praktikës gjyqësore. Praktikantëve do t'u mundësohet që në rastet kur gjyqtarët kanë nevojë profesionale për ushtrimin e funksionit të tyre gjyqësor, të ofrojnë shërbimin profesional në kuadër të këtij programi për gjykatën përkatëse. KGJK nuk merr përsipër asnjë detyrim financiar apo çfarëdo lloji tjetër të shpenzimit në raport me praktikantët. KGJK merr përsipër që t'i njoftoj kryetarët e gjykatave themelore në lidhje me programin e praktikës, dhe t'u kërkoj atyre që praktikantët të angazhohen brenda mundësive sa më shumë në

realizimin e detyrave të gjykatave, zvogëlimin e rasteve të mbetura gjyqësore, dhe administrimin më të mirë gjyqësor.

Neni 4 [Përgjegjësitë e GLPS-së]

Grupi për Studime Juridike dhe Politike merr përsipër që të menaxhoj në tërësi Programin e Praktikës së Juristëve në Gjykatat e Kosovës, sa i përket përzgjedhjes dhe rekrutimit të praktikantëve në mënyrë transparente dhe bazuar në kritere të qarta të meritës, menaxhimin e mbarëvajtjes së punës së tyre, si dhe monitorimin dhe vlerësimin e punës së tyre të përditshme, në bashkëpunim me gjykatat. Më tutje, GLPS do jetë përgjegjëse për kontraktimin e praktikantëve, sipas parimeve të qarta të së drejtës së punës, dhe kompenzimin e tyre sipas ligjit në fuqi (përfshirë pagesën e tatimit dhe kontributeve pensionale për ta). Procesi i rekrutimit të praktikantëve do të kaloj në këto faza, së paku:

- a. Shpallja e Thirrjes Publike në gazetatat ditore, me detaje të përcaktuara rreth procedurës së rekrutimit dhe kritereve për angazhim;
- b. Organizimi i një testi me shkrim, në mënyrë të tillë që, kandidatëve t'u dëshmohej në formë transparente mundësia për konkurrencë të lirë përmes dijes në fushën juridike;
- c. Organizimi i një procesi intervistimi, dhe përzgjedhja e atyre që më së miri i plotësojnë kushtet;
- d. Organizimi i procesit të rekrutimit do të bëhet në ndërlidhje dhe koordinim të drejtëpërdrejtë me zyrën e INL në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Kosovë.

GLPS nuk mund të shfrytëzoj këtë Memorandum Bashkëpunimi për asgjë tjetër, pos për zbatimin e Projektit 'Fostering Demand for Justice in Kosovo through Informed Engagement of Civil Society' (shqip: "Nxitja e Kërkesës për Drejtësi në Kosovë përmes Angazhimit të Shoqërisë Civile"), numri i kontratës: SINLEC19GR0031, financuar nga: Departamenti i Shtetit Amerikan, përmes programit - Bureau of International Narcotics and Law Enforcement Affairs (INL), zbatuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike.

Neni 5 [Parimet që qeverisin këtë Memorandum]

Palët pajtohen që në zbatimin e këtij Memorandumi të ndjekin parimet e transparencës së plotë, integritetit dhe angazhimit në mirëbesim ndërmjet tyre.

Neni 6 [Raportimi për zbatimin e Memorandumit]

Palët pajtohen që çdo pjesë e zbatimit të këtij Memorandumi t'i raportohet Programit INL dhe Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, në kuptim të angazhimit të përbashkët për zbatim transparent ndaj donatorit.

Neni 7 [Zgjidhja e Memorandumit]

Palët mund të zgjidhin këtë Memorandum në rastet kur ekzistojnë kushtet objektive që e arsyetojnë një gjë të tillë dhe pasi të marrin edhe mendimin e donatorit të projektit INL.

Neni 8 [Kohëzgjatja]

Ky Memorandum zgjat deri në përfundim të Projektit, që është objekt i këtij Memorandumi (por jo më shumë se 12 muaj nga dita e nënshkrimit të tij).

Neni 9 [Nënshkrimi i Memorandumit]

Ky Memorandum nënshkruhet nga Palët, pasi të jetë vendosur lidhur me te nga KGJK, ndërsa fillon së zbatuari nga dita e nënshkrimit të tij.

Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të plotësohet apo ndryshohet me marrëveshje me shkrim nga të dy palët.

Ky Memorandum nënshkruhet në dy kopje të njëjta, nga një kopje për gjithsecilën palë.

Palët Nënshkruese



Nehat IDRIZI

Kryesues,

Këshilli Gjyqësor i Kosovës



Për GLPS:

Njomza ARIFI

Drejtoresha e Programit/ Drejtoresha e Projektit të INL

Data dhe Vendi: Prishtinë, 30.01.2019